



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Seykos ShPK" të datës 05.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "123 Furnizimi me kontejnerë për mbeturina Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-6754-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Seykos ShPK" të datës 05.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "123 Furnizimi me kontejnerë për mbeturina Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-6754-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Seykos" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 05.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "123 Furnizimi me kontejnerë për mbeturina Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-6754-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

"Te FDT neni 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, AK ka kërkuar, po citojmë: 1. "ISO standardet nga prodhuesi ISO 9001, ISO 14001, ISO 50001; 2. Kopja e certifikatave ISO te noterizuara dhe me afat te vlefshmërisë. Vërejtjet tona për këtë kërkesë: - Lidhur me kërkesën për ISO Certifikatat fillimisht duam të ju informojmë se ISO 50001 është Standard i cili është në kundërshtim me kërkesën e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe produktet të cilat do të ofertohen. - ISO 50001 ka të bëjë me zhvillimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë dhe si standard nuk është i detyrueshëm .

Në lëmine e prodhimit të shportave të mbeturinave kompanit prodhuese kryesisht përdorin standardin ISO 45001, që në këtë rast konsiderojmë se Autoritetit Kontraktues ka mundur ti rrëshkas pa dashje standardi 50001 në vend të 45001. - Sa i përket ISO Standardeve të noterizuara, konsiderojmë se është e pa nevojshme dhe kriter i cili nuk ka as një lloj efekti si teknik as administrativ, përderisa ne si OE mund të ofrojmë certifikatat te skanuara nga ORIGJINALI të prodhuesit si dhe certifikatat tona, dhe ne rast se AK e sheh te arsyeshme mund të i verifikoj për vlefshmërinë dhe originalitetin e tyre, si ne web faqen e prodhuesit apo ofertuesit, e po ashtu edhe ne web faqen e agjencisë/institutit që i lëshon po të njëjtat. Po ashtu është vërtetuar dhe është me se e vërtet se cdo certifikatë ISO është lehet e verifikueshme ne cilëndo faqe apo motori te kërkimit ne internet. Ne anën tjetër është e pa mundur dhe kërkesë e pa justifikueshme për cdo prodhues e sidomos për prodhuesit nga te cilët furnizohemi ne, që te ju kërkohet noterizimi i certifikatave ISO. Ne po ashtu mendoj se një kërkesë e tille është gabim nga ana juaj, sepse noterizimi vlen vetëm për kopjet e dokumenteve dhe jo për origjinalet e dokumenteve. Prandaj ne konsiderojmë se një kërkesë e tille është jo e drejte dhe duhet te eliminohet ose të korrigojohet, dhe që vetëm dokumente e kopjuara duhet te noterizohen për te vërtetuar origjinalitetin e tyre dhe jo origjinalet. - Po ashtu te kjo kërkesë AK nuk ka precizuar qarte (kërkesa nuk është e qarte), sepse nuk precizohet nëse ISO Certifikatat është kërkuara të dorëzohet si dëshmi vetëm për Kontejnerë apo edhe për prodhuesit e produkteve 3 dhe 4. Prandaj, konsiderojmë se si e tille, kjo kërkesë gjate fazës se vlerësimit te ofertave mund te ketë dy kaheje të ndryshme, prandaj do te ishte mirë që nga AK të sqarohet edhe këtë kriter. 2. "Autorizimi nga prodhuesi për produktet e ofruara; Kopjen e autorizimit nga prodhuesi te nënshkruar dhe të vulosur " mbyllet citati. Vërejtja jonë për këtë kërkesë: Lidhur me kerkesat për Autorizimin, AK nuk ka përcaktuar nëse duhet të dorëzohen autorizimet për të gjitha produktet që jane pjesë e këtij tenderi, apo vetëm për kontejnerë, kjo pasi që produktet 3 dhe 4 mund të mos prodhohen nga prodhuesi i kontejnerëve dhe të njëjtat duhet të sigurohen nga prodhues të ndryshëm. 3. Mostrat duhet të sillen gjatë tenderimit për pozicionin (1) - duke përfshirë logon e stampuar në anën e përparme të kontejnerit (gjatë fazës së tenderimit me llogo) sipas specifikimit, 2 me llogo, 3 dhe 4 ; Mostrat e kërkuara duhet te dërgohen para ose ne datën dhe ne kohen e ofertimit. Pas datës dhe kohës se caktuar ne dosjen e tenderit për ofertim mostrat e dërguara nuk pranohen. Vërejtja jonë për këtë kërkesë: Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që të dorëzohen mostrat për të gjitha pozicionet, çka është plotësisht e drejte dhe ligjore, ndërkaq për pozicionin 1 dhe 2 ka kërkuar që mostrat e ofruara të kenë të stampuar edhe Llogon e Komunës se Prishtinës, për derisa ne dosjen e tenderit nuk është ofruar asnjë

Logo zyrtare, si mostër, e cila duhet të stampohet ne mostrat e produkteve të kërkuara, apo ndonjë specifikacion i kësaj logoje që ju kërkonte të stampohet ne këto produkte (Përcaktimi i madhësisë së Logos është me rendësi për faktin nëse e njëjta llogo mund të përdoret edhe ne kontejnerët 1100l si dhe ne kontejnerët prej 240l, apo duhet të bëhen 2 stampe me madhësi të ndryshme të Logos për secilin lloj të kontejnerëve). Një kërkesë e tillë për stampim të logos, përveç që shkakton shpenzime të pa nevojshme dhe dëme materiale për cdo OE i cili nuk do të shpallet fitues duke i lenë ne stocë disa produkte me llogo të një institucioni tjetër, dhe mund të jete diskriminuese për OE të caktuar, ne anën tjetër kjo kërkesë është edhe favorizuese për OE e veçanërisht për OE i cili ka furnizuar kontejnerët nga tenderi paraprak i cili veç se i ka të gatshme mostrat e kërkuar nga ju. Një kërkesë e tillë për stampimin e logos tuaj mund të i kërkohe vetëm nga OE i shpërblyer me kontratë. Prandaj, ne konsiderojmë se kjo kërkesë ne këtë fazë të tenderimit për stampim të logos është diskriminuese dhe e pa nevojshme, dhe nuk përcakton as një kriter teknik apo administrativ për produktet e kërkuara, prandaj edhe kërkojmë që të eliminohe. 4. Te FDT neni 9.1&9.2 ju keni kërkuar po citoj; Demonstrimi i kompotabilitetit të sistemit SMART (lexuesve dhe qipave) të kontejnerit me softwerin ekzistues në Komunën e Prishtinës gjatë vlerësimit të ofertës ku OE do të njoftohet 72 orë më herët. Demonstrimi duhet bërë gjatë vlerësimit të ofertës. OE duhet të paraqesë një përshkrim të detajuar dhe mënyrën e funksionimit të sistemit, ku të tregohen qartë artikujt e kërkuar së bashku me skicat. Deklarate me shkrim ku duhet të paraqesë një përshkrim të detajuar dhe mënyrën e funksionimit të sistemit, ku të tregohen qartë artikujt e kërkuar së bashku me skicat. E po ashtu edhe të specifikimi teknik pozicioni (4) ju keni kërkuar po citoj "Lexuesi duhet të jetë kompatibil me softuerin ekzistues (C-Ware con C Trace GmbH). Vërejtja jonë për këtë kërkesë: - Ne konsiderojmë se një kërkesë e tillë është diskriminuese për cdo OE dhe e favorizon drejtpërdrejt një OE të caktuar dhe sistemin e instaluar si dhe prodhuesin e këtij softweri. Po ashtu kjo kërkesë është edhe e pa qarte, sepse përderisa ne pjesën e parë ju kërkonte "Demonstrimi i kompotabilitetit të sistemit SMART (lexuesve dhe qipave) të kontejnerit me softwerin ekzistues në Komunën e Prishtinës" ne pjesën e dytë të kësaj kërkesë ju kërkonte "OE duhet të paraqesë një përshkrim të detajuar dhe mënyrën e funksionimit të sistemit", pra ju kërkonte nga OE të ofertojnë një demonstrim dhe përshkrim të një sistemi dhe softweri që e posedoni ju si AK, çka është e pa mundur për ne si OE, sepse, këtë mund ta bëjë vetëm OE i cili e ka furnizuar këtë sistem apo prodhuesi i porositur nga ju apo ju si AK. Ndërsa sa i përket kërkesës për "një përshkrim të detajuar dhe mënyrën e funksionimit të sistemit" ne me siguri se mund të paraqesim vetëm sistemin e prodhuesit tone, i cili mund të jete i veçantë dhe i ndryshëm nga sistemi i "C-Ware con C Trace GmbH". Prandaj ne konsiderojmë se kjo kërkesë është diskriminuese për faktin se AK, ose do të duhej të jepte detajet e këtij sistemi që OE dhe prodhuesit e kontinjereve të mund të i përshtaten, ose të posedojnë të drejtën dhe kodet e këtij softweri që të mundësojë leximin e cdo kodi të cdo prodhuesi të kontejnerëve, ose të instalojë vete barkodet sipas kërkesave të këtij softweri. Ne të kundërtën kjo kërkesë i pamundëson cdo prodhuesi tjetër të ofroj çfarëdo lloj tjetër kontejneri apo barkodi, pa marrë autorizimin apo pëlqimin e prodhuesit të këtij softweri, apo thënë ndryshe kjo kërkesë e favorizon drejtpërdrejt një OE të caktuar dhe i pamundëson ofertimin OE të tjerë. Sepse ne si OE ofertues edhe nëse kërkojmë

autorizime apo te drejtën e përdorimit te këtij softweri ky prodhues nuk do e lejoj, përveç OE me te cilin veç se ka kontratë ose me lejen e ju AK. Dhe krejt në fund, pas një kërkimi të vogël në shfletuesit e internetit, ne besojmë se specifikimet për pozicionin #3 janë copy-paste nga broshura C-trace të cilën ju bashkangjesim me Ankesë. Lidhur me pozicionin #4, specifikat përmendin: Lexuesi duhet të jetë i pajtueshëm me softuerin ekzistues (C-Ware me C Trace GmbH), kjo nënkupton se AK i referohet disa skanerëve shumë specifike që janë nga C-trace dhe detyrimisht favorizon vetëm një OE i cili tashmë ka instaluar këtë program pranë AK dhe ka marrëveshje me kompanin në fjalë. Prandaj, ne kërkojmë qe kjo kërkesë të përmirësohet, dhe të eliminohen kriteret diskriminuese dhe favorizuese. Si dhe te sqarohet sakte përgjegjësia e AK”.

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit**, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Me datë 12.08.2024 njësia kërkuese ka ofruar sqarimet mbi pretendimet ankimore të parashtruesit si në vijim:

*“1. Specifika e kontejnerëve të mbeturinave me Standardin ISO 50001 është e dobishme për AK, sepse siguron që kontejnerët janë projektuar me efikasitet energjetik, duke çuar në uljen e kostove operative me kalimin e kohës dhe uljen e emetimeve të gazrave serrë. Një standard të tillë e posedojnë disa kompani në tregun Evropian dhe nuk është e parashikuar që kontejnerët të jenë nga një prodhues i vetëm.*

*-Kërkesa për Standardet ISO të noterizuara është e domosdoshme për AK, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohemi për vërtetësinë e këtyre dokumenteve.*

*-ISO Standardet janë të kërkuara vetëm për pozicionet 1 dhe 2. Megjithatë për shkak të rëndësisë së këtij projekti nëse e shifni të domosdoshëm e këtij kriteri edhe mund të largohet si kërkesë.*

*2. Është e rëndësishme që për secilin pozicion të ketë një autorizim nga Prodhuesi ose Kompania që ka përfaqësinë për shitjen e Produkteve dhe nuk është e domosdoshme që Prodhuesi të jetë i njëjtë në të gjitha pozicionet; pra, ju mund të ofroni autorizime nga 4 prodhues të ndryshëm.*

*3. Në mënyrë që të identifikohen më mirë kontejnerët dhe të kenë një pamje më të mirë, komuna ka paraparë që kontejnerët të kenë të stampuar logon e Komunës së Prishtinës në pjesën e përparme. Dërgimi i mostrave me logon të ngjitur (STICKER) është gjithashtu i pranueshëm dhe nuk do të jetë arsye për eliminim, ashtu siç është cekur në dosjen e Tenderit: „Mostrat duhet të sillen gjatë tenderimit për pozicionin 1, duke përfshirë logon e stampuar në anën e përparme të kontejnerit (gjatë fazës së tenderimit me logo) sipas specifikimit, për pozicionet 2 me logo, 3 dhe 4“. Paraqitja e logos së stampuar në mostrat e dorëzuara për vlerësim ia bën fituesit të pamundur mosrealizimin e kësaj kërkesë në të ardhmen. Dimensionet e parapara nga Komuna për stampimin e logos nuk janë specifikuar me qëllim për të mos komplikuar procesin (pra mund të jenë të ndryshme njafton*

që llogo të jetë e dukshme). Ndërsa logoja mund të gjendet në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <https://prishtinaonline.com/>, e cila është hyjnesha në front me mbishkrimin PRISHTINA.

4. Gjatë Demonstrimit është parashikuar që ju të demonstroi mënyrën e funksionimit të Scanner-it dhe jo të Software-it, si dhe kompatibilitetin/funksionimin me Software-in ekzistues të Komunës, C-Ware nga C-Trace GmbH. Softueri C-Ware është një aplikacion i cili mund të shkarkohet në Scanner të ndryshëm që bëjnë leximin e Chipave RFID dhe në këtë mënyrë kjo është në përputhje me të gjitha dispozitat. Arsyeja pse është kërkuar që të jetë kompatibel është pasi që për ne si AK do ta kishim të pamundur montrimin e ofrimit të shërbimit në të kundërtën, pra sikurse për çdo furnizim të kemi lexues, chipa dhe software të ri kjo do ta bënte të pamundur procesin e monitorimit”.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 13.08.2024**



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.